

Bazat dhe parimet e Republikës dhe Kantonit të Neuchâtel-it

KËNDVËSHTRIM NË DYMBËDHJETË PIKA

TË ARDHUR NGA NJË SHTET APO KANTON TJETËR, JU VENDOSINI NË KANTONIN E NEUCHÂTEL-IT. DUKE JETUAR ATJE, JU MIRËPRISNI TË ARDHUR TË RINJ E TË REJA. CILËT JANË THEMELET E KËTJË SHTETI QË JU KENI ZGJEDHUR PER TË JETUAR? ÇFARË ËSHTE AJO QË QUHET NJË «REPUBLIKË DEMOKRATIKE, LAIKE, SOCIALE DHE GARANTE E TË DREJTAVE THEMELORE», SIÇ E PERCAKTON ARTIKULLI I PARË I KUSHTETUTËS SË NEUCHÂTEL-IT TË 24 SHTATORIT TË VITIT 2000? PËR TË JU SHPJEGUAR DHE PËR TË JU NDIHMUAR TA NJIHNI MË MIRË KANTONIN E NEUCHÂTEL-IT, NE PO JU DREJTOJMË KËTË PAKETË DOKUMENTASH, QË PERMBAN «THEMELET DHE PARIMET E REPUBLIKËS DHE KANTONIT TË NEUCHÂTEL-IT», NJË BROSHURË TË TITULLUAR «MIRË SE VJEN», NJE AGJENDË KULTURORE, ASHTU SI EDHE NJË PROGRAM KURSESHE TË NJOHURIVE TË QYTETARISË.

PSE NJË PERÇAPJE E TILLË

Themelet dhe principet e një shteti janë në përgjithësi të përshkruara në ligjet, të cilat janë rregulla juridike konkrete, që çdokush, zviceran apo i huaj, është i detyruar t'i respektojë. Edhe pse nuk ka asnjë detyrim ligjor që të detyron të njihesh me këto parime, duhet megjithatë, që pjesa më e madhe e popullsisë t'i njohë, ti respektojë ato dhe të angazhohet për t'i mbrojtur, në mënyre që një Shtet si Neuchâtel-i të funksionojë si duhet.

SI PËRCAKTOHET REPUBLIKA DHE KANTONI I NEUCHÂTEL-IT?

Një shtet liberal, demokratik, social dhe laik. Kjo do të thotë se ai i garanton popullsisë së tij liri dhe të drejta themelore, e përfshin atë në ushtrimin e pushtetit, i garanton qytetareve/ëve të tij mbrojtje sociale, nuk ka fe shtetërore dhe garanton lirinë fetare.

Ç'ËSHTE NJË SHTET I SË DREJTËS LIBERALE?

Një shtet që garanton të drejtat themelore të njeriut, nga të cilat së pari, dinjitetin njerëzor, që është e drejta për të mos qënë i/e trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese; ai del në mbrojtje kundrejt çdo torture dhe çdo lloj trajtimi tjetër mizor.

LIRITË A JANË TË DREJTA THEMELORE?

Sigurisht që po. Ato kanë të bëjnë me te drejtat e sferës personale, si e drejta e jetës dhe lirisë personale, e drejta e martesës, lirisë së gjuhës dhe lirisë fetare; liritë e komunikimit, që bashkojnë lirinë e mendimit dhe të shprehurit, të drejtën e informimit, të drejtën e shoqërimit, të bashkimit dhe të manifestimit; dhe së fundi, të drejtat ekonomike, si garancinë e pronës, lirinë ekonomike dhe lirinë sindikale.

ÇFARË TË DREJTASH TË TJERA JANË GJITHASHTU TË GARANTUARA?

Parimi i trajtimit të barabartë, ndalimi i diskriminimeve, ashtu si dhe të drejtat sociale, që garantojnë disa pagesa-ndihmë prej Shtetit, të dosmosdoshme për respektimin e dinjitetit njerëzor.

A MUNDET TË KUFIZOHEN KËTO LIRI?

Shteti mundet ta bëjë një gjë të tillë, mbasi disa liri janë në konflikt me njëra-tjetrën. Për shëmbull, liria e të shprehurit të disa individëve mundet, në disa raste, të përplasht me lirinë e besimeve të disa të tjerëve. Po ashtu, mundet t'i kufizojë ato në rast se ka kundërshtim midis lirisë së individit dhe interesave të bashkësisë. Por nga ana tjetër, çdo kufizim duhet të bazohet mbi një themel ligjor dhe të jetë i justifikuar nga interesi publik.

BIENVENUE
WILLKOMMEN
BENVENUTI
WELCOME
BEM-VINDO
BIENVENIDA
MIRË SE VJËN
DOBRODOŠLI
HOŞGELDİNİZ
KU SOO DHOWOW
BUN VENIT
SZERENCSESEN ERKESZTEK
VÍTEJTE
اهلا وسهلا

MIRË SE VJËN

Ç'ËSHTË NJË SHTET DEMOKRATIK?

Është një shtet ku pushteti i takon popullit. Por duhet të bëjmë dallime midis regjimeve të demokracisë së përfaqësuar, ku është populli ai që zgjedh përfaqësuesit/et e tij në një parlament apo në një qeveri, me ato të demokracisë direkte, ku populli mundet, për më shumë, të ndërhyjë drejtpërsëdrejti me nisma dhe referendume. Ky lloj regjimi është në Zvicër dhe në Neuchâtel.

KUSH ZOTËRON TË DREJTA POLITIKE?

Këto të drejta u janë dhënë shtetasve të të dyja gjinive. Në pjesën më të madhe të vëndeve të tjera, të huajt janë përjashtuar nga e drejta e shtetësisë. Në Zvicër, në nivelin federal, vetëm shtetasit dhe shtetasit zviceranë që kanë mbushur moshën 18 vjeçare e zotërojnë këtë të drejtë. Ndërsa kantoni i Neuchâtel-it e ka zgjeruar këtë të drejtë për disa kategori shtetasësh dhe shtetasish të huaj, me Kushtetutën e tij të vitit 2000.

KUSH MUND TË VOTOJË?

Në kantonin e Neuchâtel-it, ata të huaj që kanë mbushur 18 vjeç e janë të paisur me një autorizim qëndrimi të përhershëm (permis C) mundet:

- Të votojnë në planin kantonal pas jo më pak se pesë vjetëve që janë vendosur me banim në kanton.
- Të votojnë dhe të zgjidhen në planin komunal pas jo më pak se një viti që janë vendosur me banim në kanton

ÇFARË ËSHTË NJË SHTET SOCIAL?

Një Shtet social siguron një drejtësi sociale që e shpërndan tek të gjithë. Ai vendos masa sociale, në mënyrë që secili/a të mund të ketë një formacion, një punë, një banesë të përshtatshme, një mbrojtje sociale (papunësi, pleqëri, sëmundje, aksident).

Ai garanton të drejtat sociale, të domosdoshme për respektimin e dinjitetit njerëzor, të njeh të drejtën për kushte minimale të ekzistencës si dhe të drejtën për një arsim elementar të mjaftueshëm dhe falas.

SI PËRKUFIZOHET NJË SHTET LAIK?

Një Shtet laik është atëhere kur institucionet publike janë të ndara nga Feja. Kur nuk ka një besim shtetëror, por një regjim që e pranon lirinë e besimit fetar. Kjo liri përfshin lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit ashtu si edhe lirinë e kulteve. Në emër të kësaj lirie, një komunë neuchâtelase nuk mundet t'i ndalojë një nxënseje myslymane të mbajë shallin në klasë. Por kjo nuk mund të pranohet për një mësuese, mbasi është në kundërshtim me parimet e neutralitetit konfesional të shkollave publike.

Shteti ka për detyrë të jetë i hapur për të gjitha bindjet fetare dhe filozofike. Por kjo nuk e pengon atë t'u njohë të tre Kishave kristiane statusin për arsim të interesit publik. Por Kushtetuta e re e Neuchâtel-it parashikon mundësinë e shtrirjes së kësaj njohjeje të interesit publik edhe për komunitetet e tjera fetare që e kërkojnë atë.

E TOLERANCA?

Një Shtet liberal, social, demokratik dhe laik nënkupton që individët e tij ta pranojnë dhe tolerojnë shumëllojshmërinë e opinionëve. Vetëm toleranca dhe shpirti i hapur mund ta sigurojë ekuilibrin e bashkjetesës së bashkësive të përzjera.

ne.ch

RÉPUBLIQUE ET CANTON DE NEUCHÂTEL

DEPARTEMENT DE L'ECONOMIE
ET DE L'ACTION SOCIALE
SERVICE DE LA COHESION
MULTICULTURELLE
PLACE DE LA GARE 6
2300 LA CHAUX-DE-FONDS
TÉL +41 (0)32 889 74 42
FAX +41 (0)32 722 04 04

Tekstin e Kushtetutës neuchâtelase
mund ta konsultoni në adresën
internet www.ne.ch/ose
www.ne.ch/constitutionNE